

Food4Health

TITULLI	BUXHETI	KOHEZGJATJA	MODALITETI I MENAXHIMIT
Zinxhiri i vlerave të qëndrueshme dhe inovative në sektorin e agroushqimit dhe peshkimit për tregun ndërkufitar të NVM-ve.	269,000 Euro (MBZHR)	01.06.2019 – 31.12.2023	Indirekt
<p>Objektivi i përgjithshëm i projektit FOOD4HEALTH është të rrisë konkurrencën e NVM-ve dhe të favorizojë aksesin në treg në zonën ndërkufitare përmes përmirësimit të teknikave të prodhimit, transferimit, ndarjes dhe miratimit të standardeve evropiane të cilësisë dhe përmirësimit të produkteve tipike dhe tradicionale të sektorit agroushqimor dhe të peshkimit.</p> <p>Statusi i Projektit: Projekti ka përfunduar me 31 Dhjetor 2023.</p>			

World Bank Project

TITULLI	BUXHETI	KOHEZGJATJA	MODALITETI I MENAXHIMIT
Qëndrueshmëria ndaj Klimës dhe Zhvillimit të Bujqësisë World Bank Project	70,000,000 USD	Deri me 30 Shtator 2028	Indirekt

Objektivi i përgjithshëm: Rritja e konkurrencës dhe elasticitetit klimatik të zinxhirëve të vlerës prioritare agroushqimore.

Komponentët kryesorë të këtij projekti janë:

- **Komponenti 1:** Promovimi i bujqësisë inteligjente klimatike dhe aksesin në tregje. Objektivi i këtij komponenti është të rrisë konkurrencën e sektorit agroushqimor duke zhvilluar sektorin agroushqimor elastik dhe të zgjuar me klimën, duke përmirësuar aksesin në treg të fermerëve dhe agrobizneseve dhe duke përmirësuar sistemet e ujitjes dhe kullimit.
- **Komponenti 2:** Rritja e përputhshmërisë me standardet e sigurisë dhe cilësisë së ushqimit. Objektivi i këtij komponenti është rritja e kapaciteteve institucionale për të zbatuar kërkesat e sigurisë ushqimore, veterinarë dhe fitosanitare duke adresuar mekanizmat e dobët të pajtueshmërisë dhe kontrollit në lidhje me standardet e sigurisë ushqimore, veterinarë dhe fitosanitare.
- **Komponenti 3:** Forcimi i kapaciteteve analizuuese të bazuara në dëshmi të MBZHR dhe komunave. Objektivi i këtij komponenti është krijimi i një sistemi të qëndrueshëm dhe efektiv monitorimi dhe vlerësimi (M&E) për politikat bujqësore dhe të zhvillimit rural në Shqipëri. Rezultati i prituri është rritja dhe rritja e kapacitetit të MBZHR për formulimin, zbatimin dhe monitorimin dhe vlerësimin e politikave të bazuara dhe efektive.

Statuasi i Projektit:

Marreveshja u bë efektive me 15 Shkurt 2024 dhe që nga ajo datë ka filluar zbatimin e projektit. Është miratuar Manuali Operacional i Projektit (POM) dhe është ngritur Njesia e Menaxhimit të Projektit në MBZHR.

Ekonomia Blu

TITULLI	BUXHETI	KOHEZGJATJA	MODALITETI I MENAXHIMIT
Ekonomia Blu	25,000,000 Kredi	36 muaj	Indirekt

Objektivat:

1. Përmirësimi i infrastrukturës së portit të peshkimit të Durrësit dhe Vlorës.
2. Përmirësimi/ fuqizimi i peshkimit në shkallë të vogël nëpërmjet investimit në 9 mole peshkimi (landing sites) përgjatë bregdetit dhe në ujrat e brendshëm, i cili mbështet procesin e formalizimit të peshkimit artizanal, konkretisht në:
 - Kepin e Rodonit, Durrës;
 - Radhimë, Orikum, Vlorë;
 - Karpen, Durrës;
 - Tale, Shëngjin, Lezhë;
 - Bunë, Velipojë – Shkodër;
 - Liqenin e Ohrit, Mëmëlisht, Pogradec;
 - Liqenin e Prespës, Pustec;
 - Divjakë, Fier;
 - Malësi e Madhe, Shkodër
3. Ndërtimit të dy tregjeve të peshkimit në zonën bregdetare (Shkodër, Sarandë)
4. Rritja e kapaciteteve të Organizatës së Menaxhimit të Peshkimit në zonën e Liqenit të Prespës, Liqenit të Ohrit, Liqenit të Ulzës dhe Fierzës dhe kontribut në peshkimin e përgjegjshëm, ruajtjen e natyrës dhe përmirësimin e ekosistemit.
5. Përgatitja e planeve të menaxhimit për molet e peshkimit dhe markatat e peshkut.

Buxheti

Plani financiar dhe pasqyra e kostove				
N.	Kategoritë e Aktiviteteve	Kostoja e parashikuar (Euro)		% e totalit
		Italia	Shqipëria	
0	Ofrohet mbështetje teknike për MBZHR	684,100		2.74%
1	Përmirësimi i kushteve të përgjithshme në infrastrukturën e peshkimit në portet e Durrësit dhe Vlorës dhe zgjerimi i kapaciteteve të qendrës së depurimit të midhjeve në liqenin e Butrintit.	11,460,000	-	45.84%
2	Rritja e konkurrencës dhe modernizimi i Peshkimit në Shkallë të Vogël (SSF) në të gjithë bregdetin shqiptar dhe ujërat e brendshme 9 Vende zbarkimi (përfshirë kostot e supervizionit)	9,533,900	-	38.13%
3	Rritja e formalizimit të sektorit të peshkimit (Ndërtimi i dy tregjeve të peshkut në Shkodër, Sarandë / Ksamil)	2,220,000		8.88%
4	Rritja e kapaciteteve të Organizatës së Menaxhimit të Peshkimit në zonën e Liqenit të Prespës, Liqenit të Ohrit dhe Liqenit të Ulzës duke siguruar peshkim të qëndrueshëm në shkallë të vogël në kontekstin e sigurisë ushqimore, duke dhënë fund varfërisë dhe duke kontribuar në peshkimin e përgjegjshëm, ruajtjen e natyrës dhe përmirësimin e shërbimeve të ekosistemit	225,000	-	0.90%
5	Konsolidimi dhe garantimi i funksionimit dhe mirëmbajtjes së 9 "vendeve të zbarkimit" dhe 2 tregjeve të peshkut.	501,400	--	2.00%
6	Standardet e cilësisë së molusqeve bivalvare dhe produkteve të peshkut janë përmirësuar dhe garantuar.	375,600	-	1.10%
	<i>Totali për burim financimi</i>	25,000,000	-	100%
	<i>% për burimin e financimit</i>	100%	0%	100%
	TOTALI I PLOTË	100	0	100

Landing site ofrojnë këto shërbime:

- Shërbimet për varkat: për shkarkimin e kapjes, për ngarkimin e mjeteve të peshkimit etj.;
- Furnizimi me karburant: një stacion i thjeshtë karburanti me naftë ose benzinë nga i cili anijet e peshkimit mund të marrin furnizimin e tyre drejtpërdrejtë;

- zona e riparimit të varkave;
- zonat e riparimit rrjetave;
- objektet e peshkatarëve;
- prodhimi i akullit;
- magazinimi në të ftohtë;
- sallë tregu me ambiente për operacionet e marketingut.

Porti Vlorë




Porti Sarandës

Nuk ka informacion nëse ka një Projekt-plan



Durres
Markata e Peshkut



Investimet në bankinat në portin e peshkimit Durrës



Me te kuqe Lot I ku po ndërhyhet me fondet e buxhetit të shtetit

Me blu Lot II ku do të ndërhyhet me Fondet e kredisë Economia Blu

Safial

TITULLI	BUXHETI	Statusi	Modaliteti i menaxhimit
Forcimi institucional i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për menaxhimin e Sigurisë Ushqimore (SAFIAL)	2,400,000 €	Kohëzgjatja: 06/2021 - 06/2024	Direkt (Projekte të financuara nga Qeveria Italiane)
<p>Objektivi: Ky projekt synon rritjen e performancës së autoriteteve shqiptare në lidhje me inspektimin dhe kontrollet në materialin bimor dhe produktet veterinarë.</p> <p>Aktivitete të realizuara:</p> <p>-Rritja e aftësisë së AKU për të kryer inspektime efikase të mallrave që hyjnë në portin e Durrësit dhe ndërhyrje përmirësuese të infrastrukturës në laboratorin e Durrësit: -Rritja e aftësisë së Autoriteteve Shqiptare për të verifikuar nivelet e mbetjeve pesticide në ushqimin me origjinë bimorë dhe aftësitë për diagnostikimin e agjentëve të mundshëm</p> <p>-Forcimi dhe organizimi i shërbimit veterinar të Ministrisë së Bujqësisë. Partnerët e projektit janë MBZHR, AKU, ISUV, AKVMB.</p> <p>Investimet dhe Përmirësimet Kryesore</p> <ol style="list-style-type: none">Pika e Inspektimit Kufitar (BIP) e AKU-së në Durrës:<ul style="list-style-type: none">Ndërtimi dhe pajisja e një BIP të ri dhe modern, i cili përfshin një magazinë, një platformë për ngarkim-shkarkim, dhoma të ftohta/refriferuara, një karrocë elektrike për lëvizjen e mallrave, dhe ambiente pune të pajisura plotësisht.Kjo strukturë është operacionale që nga prilli 2023 dhe mundëson inspektime të shpejta dhe efikase të ngarkesave ushqimore të importuara, sipas standardeve evropiane.Laboratorët e AKU-së dhe ISUV:<ul style="list-style-type: none">Investime të rëndësishme në laboratorët e AKU-së në Durrës, përfshirë pajisje për analizat fiziko-kimike, mikrobiologjike dhe diagnostikën fitosanitare.Përmirësimi i laboratorëve të ISUV-it për mbrojtjen e bimëve dhe analizat ushqimore, përfshirë pajisje të reja për analizat molekulare dhe serologjike të patogjenëve të ndryshëm bimorë.Mbështetje për Sektorin Veterinar:<ul style="list-style-type: none">Furnizimi i automjeteve dhe pajisjeve për monitorimin dhe regjistrimin e kafshëve.Trajnime për specialistët e ISUV-it dhe AKU-së në Itali dhe Shqipëri për përmirësimin e kapaciteteve të tyre teknike dhe menaxheriale.			

Rezultatet dhe Ndikimet Kryesore

- Rritja e kapacitetit të inspektimit dhe kontrollit të produkteve ushqimore në portin e Durrësit.
- Përmirësimi i kushteve të punës për inspektorët dhe specialistët laboratorikë.
- Reduktimi i rreziqeve për punonjësit dhe mjedisin përmes masave të sigurisë së përmirësuar në laboratorë.
- Rritja e ndërgjegjësimit dhe përmirësimi i proceseve për pajtueshmërinë me standardet e BE-së.

Statusi

Projekti ka përfunduar në muajin Qershor. Agjencia implementuese CIHEAM Bari do të përgatisë dhe dorëzojë raportin përfundimtar brenda gjashtë muajve të ardhshëm. Kjo do të përfshijë të gjitha detajet dhe analizat e arritjeve të projektit dhe ndikimeve të tij në sigurinë ushqimore dhe sistemet inspektuese në Shqipëri.

Përmirësimi i standarteve të sigurisë ushqimore në zinxhirin e prodhimit të produkteve tipike lokale shqiptare

TITULLI	BUXHETI	KOHEZGJATJA	MODALITETI I MENAXHIMIT
Përmirësimi i standarteve të sigurisë ushqimore në zinxhirin e prodhimit të produkteve tipike lokale shqiptare.	3,000,000 Euro	36 muaj	Direkt

Objektivi i përgjithshëm:

Mbështetje për autoritetet shqiptare në forcimin e aftësive në drejtim të prodhimit dhe përpunimit të produkteve tipike vendase në përputhje me standartet e BE-së.

Rezultatet e Pritshme

- Analizimi i zinxhirit të furnizimit dhe karakteristikat nutritive të produkteve tipike lokale;
- Përmirësimi dhe forcimi i shërbimeve publike dhe private të përfshira në kontrollin e sigurisë ushqimore të produkteve tipike shqiptare;
- Forcimi i qasjes ndaj komunitetit të laboratorëve (inkubatorët ushqimorë) në lidhje me përpunimin ose furnizimin e shërbimeve për zinxhirët e shkurtër të produkteve tipike lokale.
- Zhvillimi dhe shpërndarja e rregulloreve (protokolleve) për menaxhimin e sigurisë ushqimore në zinxhirët e furnizimit të produkteve tipike shqiptare
- Përhapja/ Komunikimi i standarteve dhe metodologjive që do të propozohen përmes fushatave të përshtatshme promovuese me qëllim zhvillimin prodhimin dhe tregtimin e produkteve tipike shqiptare.

Statusi i Projektit:

Projekti është në zbatim. Është miratuar plani i punës pas takimit të Komitetit Drejtues. Është caktuar një koordinator kombëtar për ndjekjen e aktiviteteve.

Mbështetje institucionale për Shqipërinë në sektorin e bujqësisë dhe peshkimit drejt anëtarimit në BE

TITULLI	BUXHETI	KOHEZGJATJA	MODALITETI I MENAXHIMIT
Mbështetje institucionale për Shqipërinë në sektorin e bujqësisë dhe peshkimit drejt anëtarësimit në BE.	2,500,000 Euro	36 muaj	Direkt
<p>Objektivi i përgjithshëm: Ky projekt synon forcimin e kapaciteteve institucionale në arritjen e përputhshmërisë me Acquis të Komunitetit Evropian lidhur me përafrimet dhe aktet rregullative për kapitullin 11 si dhe në kapitullin 13.</p> <p>Statusi i Projektit: Projekti është në zbatim. Është emëruar Koordinatori Kombëtar për ndjekjen e aktiviteteve të projektit.</p>			

UN Women

TITULLI	BUXHETI	Statusi	Modaliteti i menaxhimit
Fuqizimi i grave për zhvillimin rural në Shqipërinë e Veriut	3,000,000 €	36 muaj	Direkt (UN Women Albania)
<p>Përshkrim i shkurtër i projektit: Projekti i propozuar synon të përmirësojë të drejtat socio-ekonomike të grave rurale në Shqipërinë e Veriut 2026 përmes tre rezultateve kryesore dhe rezultateve të tyre përkatëse.</p> <p>Rezultati 1: Deri në vitin 2026, gratë rurale në Shqipërinë e Veriut do të kenë të drejta të përmirësuara socio-ekonomike.</p> <p>Rezultati 1.1: Ky rezultat fokusohet në rritjen e angazhimit në nivel lokal dhe kombëtar për zbatimin politikat dhe planet në përputhje me standardet e BE-së dhe ndërkombëtare për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave.</p> <p>Rezultati 1.2: Ky rezultat synon të rrisë ndërgjegjësimin për të drejtat e grave dhe të luftojë stereotipet gjinore në Shqipërinë e Veriut. Ai përfshin fushata edukative dhe ndërgjegjësuese për të drejtat e grave, aksesin ndaj të drejtave pronësore dhe mashkullorive pozitive.</p> <p>Produkti 1.3: Ky rezultat fokusohet në rritjen e kapacitetit të ofruesve të shërbimeve për të mbështetur të mbijetuarit e dhunes, me fokus të veçantë në këshillimin psiko-social, ndihmën juridike falas.</p> <p>Rezultati 2: Deri në vitin 2026, grupet e grave në zonat rurale veriore do t'u jenë rritur të ardhurat dhe mundësitë e punësimit.</p> <p>Rezultati 2.1: Ky rezultat synon të fuqizojë gratë rurale duke analizuar zinxhirët e vlerave me një sens gjinor qasje, promovimin e praktikave të mira bujqësore, ofrimin e trajnimeve dhe mbështetjen e grave sipërmarrëse.</p> <p>Rezultati 2.2: Ky rezultat fokusohet në ofrimin e arsimit dhe formimit profesional në bujqësi dhe agroturizem për të rinjtë ruralë, veçanërisht për gratë e reja. Ai përfshin ofrimin e bursave, mbështetjen e shkëmbimet me shkollat evropiane dhe lehtësimi i zbatimit të aftësive dhe njohurive të fituara përmes projekteve të vogla. Projekti do të synojë kryesisht komunitetet rurale në Shqipërinë e Veriut, me fokus të veçantë në gratë, duke përfshirë të mbijetuarat e dhunës, gratë kryefamiljare, gratë në varfëri dhe ato në komunitetet e marginalizuara.</p> <p>Statusi: Ne pritje të përgatitjes së marrëveshjes së zbatimit.</p>			

SA Skills

TITULLI	BUXHETI	Statusi	Modaliteti i menaxhimit
SA SKILLS	270,778 EUR	52 months	Indirekt
Objektivi: <p>Projekti SA Smart-Skills synon të përmirësojë disponueshmërinë e kompetencave të kualifikuara dhe aftësitë në tregun u, veçanërisht në sektorin e ekonomisë blu. Përmes një qasjeje ndërkufitare, projekti ndërmerr veprime specifike për të adresuar sfidat kryesore të mungesës, nënkualifikimit, dhe mospërputhja e aftësive në sektorët e ekonomisë blu në zhvillim si bioteknologjitë blu dhe turizmi blu. Konkretisht, projekti do të:</p> <ol style="list-style-type: none">1. Krijojë një dialog të përhershëm ndërmjet palëve të interesuara në arsim, trajnime dhe sisteme profesionale, që mundësojnë përcaktimin e një gjuhe të përbashkët ndërkufitare, a sistem i harmonizuar i kualifikimeve dhe prioritete të përbashkëta për zhvillimin dhe përmirësimin e aftësive të punës.2. Zhvilloje kurrikula të reja arsimore dhe shtigje trajnimi që prezantojnë profesionistë të rinj dhe të avancuar tregun e punës, duke kapërcyer hendekun në aftësitë e kërkuara.3. Përmirësoje bashkëpunimin ndërmjet arsimit, sektorit biznesit në nivele të ndryshme për të reduktuar boshllëqet e aftësive midis arsimit ekzistues ofertat dhe nevojat e tregut të punës.4. Rritja e mundësive të karrierës brenda sektori te ekonomisë blu. Projekti përfshin gjithashtu krijimin e mjeteve për të përmirësuar menaxhimin e kapitali njerëzor brenda industrisë/biznesit, duke promovuar proceset e mirëqenies për punëtorët duke vlerësuar kompetencat e brendshme përmes ngritjes së aftësive dhe zhvendosjeve të suksesshme përmes rikualifikimit			
Statusi <p>Pritet te dergohet transhi i pare i fondeve te projektit dhe te fillojne aktivitetet e parashikuara per MBZHR.</p>			

Zhvillimi rural gjithëpërfshirës dhe i qëndrueshëm në Shqipërinë e Veriut

TITULLI	BUXHETI	Statusi	Modaliteti i menaxhimit
"Zhvillimi rural gjithëpërfshirës dhe i qëndrueshëm në Shqipërinë e Veriut"	5,000,000 €	36 muaj	Projekt i financuar nga AICS (Qeveria Italiane)
<p>Objektivi: Ky projekt synon forcimin e zhvillimit gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm të komuniteteve lokale në zonat rurale dhe marginale në rajonet e Shkodrës dhe Lezhës. Kjo nismë do të mbështesë zhvillimin e integruar të sektorëve të bujqësisë dhe mjedisit duke zbatuar ndërhyrje që synojnë ruajtjen dhe restaurimin e zonave natyrore, duke rritur të ardhurat e operatorëve të agrobiznesit duke mbështetur shoqatat. Gjithashtu duke përfshirë shoqërinë civile nëpërmjet aktiviteteve edukative që synojnë rritjen e ndërgjegjësimit për praktikën e qëndrueshme mjedisore në kontekstin e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike.</p> <p>Statusi: Dokumenti i projektit është miratuar nga zyrat e AICS në Rome, në pritje të përgatitjes së marrëveshjes së zbatimit.</p>			

Cultivetting

TITULLI	BUXHETI	Statusi	Modaliteti i menaxhimit
CultiVETing: Kultivimi i Ndërmarrësisë në Sektorin Agroushqimor përmes VET.	12,139 Euro	Kohëzgjatja: 12/2023 - 11/2026	Indirekt
Instrumenti i Financimit: ERASMUS2027.			
<p>Qëllimi: Projekti "CultiVETing: Kultivimi i Ndërmarrësisë në Sektorin AgroUshqimor përmes VET" është zhvilluar për të zbrapsur hendekun mes sektorit VET dhe nevojave të tregut të punës në sektorin AgroUshqimor, duke trajnuar ofruesit e VET, me qëllim zhvillimin e kurrikulave që përgjigjen ndaj tregut të punës nga njëra anë, duke promovuar në të njëjtën kohë vetë-ndërmarrësinë dhe qëndrueshmërinë nga ana tjetër. Më tej, do të krijohet një rrjet i palëve të interesit kombëtare që do të integrojë dhe promovojë Institucionet VET si motorë të ndryshimit socioekonomik në sektorin AgroUshqimor në Ballkanin Perëndimor, konkretisht në Shqipëri dhe Kosovë. Gjithashtu, përmes projektit CultiVETing, përfaqësuesit e sektorit VET, nga vendet e BE-së dhe të Ballkanit Perëndimor, do të shuajnë distancat e tyre përmes bashkëpunimit, shkëmbimit të praktikave të mira dhe zhvillimit të aktiviteteve të përbashkëta. Objektivi i përgjithshëm i projektit CultiVETing është të trajnojë stafin dhe trajnerët e VET, në lidhje me dizajnimin e kurrikulave, me qëllime të fundit për të përmbushur nevojat e tregut të punës si dhe nevojat e mësuesve, për të përputhur aftësitë thelbësore dhe vendet e punës, për të përshtatur me kërkesat e vendit të punës që ndryshojnë shpejt dhe për të nxitur aftësitë e vetë-ndërmarrësisë së mësuesve në sektorin Bujqësor. Më tej, synon të krijojë një rrjet të palëve të interesit kombëtare që do të integrojë dhe promovojë Institucionet VET si motorë të ndryshimit socioekonomik në Shqipëri dhe Kosovë.</p>			
Statusi:			
Projekti ka filluar zbatimin.			